# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**www.qpz.gov.al**

**Nr.187 31 dhjetor 2009**

PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Akt normativ nr.10, datë 23.12.2009 | Për disa ndryshime në ligjin nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e e vitit 2009", të ndryshuar .............................. | 8285 |
| Vendim i KM nr.1182, datë 3.12.2009 | Për hapjen e Institutit të Studimeve Europiane në Universitetin e Tiranës .................................................. | 8293 |
| Vendim i KM nr.1203, datë 11.12.2009 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë .................... | 8293 |
| Vendim i KM nr.1205, datë 11.12.2009 | Për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe për degën e doganës, Fier, si autoritete kontraktore ............ | 8296 |
| Vendim i KM nr.1207, datë 11.12.2009 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës nga Kopshti Zoologjik në takim me rrugën "Sami Frashëri", në bashkinë e Tiranës ...................................... | 8296 |
| Vendim i KM nr.1208, datë 11.12.2009 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i sheshit "Shtraus", në bashkinë e Tiranës... | 8297 |
| Vendim i KM nr.1210, datë 11.12.2009 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman të qarkut të Fierit ...... | 8298 |
| Vendim i KM nr.1211, datë 11.12.2009 | Për miratimin e kuotave shtesë të pranimit në programet e studimeve "Master i nivelit të dytë", në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010 ..................................................... | 8299 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.1212, datë 11.12.2009 | Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë dhe arsimin e mesëm, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi ………………… | 8300 |
| Vendim i KM nr.1232, datë 11.12.2009 | Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen …………… | 8302 |
| Vendim i KM nr.1234, datë 16.12.2009 | Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore …………………… | 8303 |
| Vendim i KM nr.1239, datë 16.12.2009 | Për një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar …. | 8305 |
| Vendim i KM nr.1241, datë 16.12.2009 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit të “Bibliotekës së kadareve” Gjirokastër ………….. | 8306 |
| Vendim i KM nr.1246, datë 23.12.2009 | Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga drejtoria rajonale rrugore, Lezhë, si autoritet kontraktor ………………………………………………………… | 8307 |
| Vendim i KM nr.1248, datë 11.12.2009 | Për disa ndryshime në vendimin nr.28, datë 24.1.2007, të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës” …………………………………………… | 8307 |
| Udhëzim i MPÇSHB nr.2306, datë 10.12.2009 | Për një ndryshim në udhëzimin nr.2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar” ………………………………………………………… | 8308 |
| Udhëzim i MPÇSHB nr.1547/1, datë 11.12.2009 | Për një shtesë në udhëzimin nr.1547, datë 27.8.2009 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”…………………………………………………………… | 8309 |
| Vendim i BSH nr.85, datë 14.12.2009 | Për tërheqjen nga qarkullimi të disa kartëmonedhave me kurs ligjor ………………………………………………………… | 8309 |
| Kërkesë e MPPTT nr.6417, datë 10.12.2009 | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Lidhja e rrugës hyrëse Kombinat me Urën e re Berat”…………………………………………………… | 8310 |
| Kërkesë e MPPTT nr.7222, datë 10.12.2009 | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i “Kalatës së Limjonit, Sarandë”………………………………… | 8312 |

**AKT NORMATIV**
**Nr.10, datë 23.12.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10025, DATË 27.11.2008 "PËR BUXHETIN E VITIT 2009", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2008", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 1

Buxheti për vitin 2009 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 319 893 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 401 512 milionë lekë; |
| Deficiti | 81 620 milionë lekë. |

Buxheti përbëhet nga Buxheti i Shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore.".

**Neni 2**

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 2

Buxheti i Shtetit për vitin 2009 është:

| | |
|---|---|
| Të ardhurat | 251 280 milionë lekë; |
| Shpenzimet | 332 900 milionë lekë; |
| Deficiti | 81 620 milionë lekë.". |

**Neni 3**

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2009 është:
1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

| | |
|---|---|
| - Të ardhurat, gjithsej | 67 109 milionë lekë. |
| Nga të cilat: | |
| - kontributet | 44 122 milionë lekë; |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 22 987 milionë lekë. |
| - Shpenzimet | 67 109 milionë lekë. |

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategori të veçanta të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga subvencionet e Buxhetit të Shtetit, por brenda kufirit të transfertave, të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2009, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

| | |
|---|---|
| - Të ardhurat, gjithsej | 4046 milionë lekë. |
| Nga të cilat: | |
| - kontributet | 200 milionë lekë; |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 3846 milionë lekë. |
| - Shpenzimet | 4046 milionë lekë.”. |

**Neni 4**

Neni 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2009 është:

| | |
|---|---|
| - Të ardhurat, gjithsej | 24 211 milionë lekë; |
| Nga të cilat: | |
| - kontributet dhe të tjera | 5879 milionë lekë; |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 18 332 milionë lekë; |
| - Shpenzimet | 24 211 milionë lekë |

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

**Neni 5**

Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Të ardhurat e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

| | |
|---|---|
| - Grantet | 6313 milionë lekë; |
| - Të ardhurat tatimore | 288 057 milionë lekë; |
| - Të ardhurat jotatimore | 25 522 milionë lekë; |
| - Të ardhurat e buxhetit vendor | 18 412 milionë lekë”. |

**Neni 6**

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 8

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 81 620 milionë lekë, nga i cili 27 794 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm dhe të huaj prej 59 626 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat e arkëtuara nga privatizimi strategjik i OSSH-së përdoren në masën 50% për reduktimin e borxhit të përgjithshëm publik. Pjesa tjetër e të ardhurave nga ky privatizim përdoren nga Këshilli i Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime, jo më shumë se 30% për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë në masën 10% dhe për kompensimin e ish-pronarëve 10%, fond i cili automatikisht rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Të ardhurat e arkëtuara nga privatizimi strategjik i ARMO sh.a., të papërdorura gjatë vitit 2008, prej 9790 milionë lekësh përdoren në masën 50% për reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe 50% nga Këshilli i Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime, i cili automatikisht rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.”.

**Neni 7**

Neni 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

| | |
|---|---|
| - Shpenzimet korrente | 217 366 milionë lekë; |
| - Shpenzimet kapitale | 100 411 milionë lekë; |
| - Rezerva e Këshillit të Ministrave | 2600 milionë lekë; |
| - Kontingjenca për ruajtjen e deficitit | 4822 milionë lekë. |

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave kufiri i shpenzimeve dhe numri i punonjësve janë sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. E drejta për të kryer shpenzime për kompensimin e të përndjekurve politikë skadon më 31 maj 2010. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si edhe nga organet e pushtetit vendor.”.

**Neni 8**

Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, prej 2600 milionë lekësh, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit është 4822 milionë lekë. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit dhe ai për rritjen e pagave e të pensioneve përdoren nga Këshilli i Ministrave.”.

**Neni 9**

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 18

Shtesa e stokut të borxhit deri në fund të vitit 2009 rritet me 84 113 milionë lekë, krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2008, e kushtëzuar si më poshtë vijon:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit për vitin 2009, është 57 136 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese, është 5003 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra, të jashtme, të papaguara, është 3650 milionë lekë.

4. Ulja e stokut të borxhit, si rezultat i rivlerësimit të valutës së Bankës së Shqipërisë, është 4 670 milionë lekë.

Kufiri i stokut të borxhit shtetëror për vitin 2009 lejohet të jetë 634 137 milionë lekë.

Kufiri i garancive shtetërore për vitin 2009 lejohet të jetë 45 756 milionë lekë.".

**Neni 10**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**BUXHETI I VITIT 2009 (AN) SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

*ne 000/leke*

| Kodi | Emertimi i Institucionit / programit | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale | | | | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nga Buxheti | Nga te Ardhurat | Financimi i Huaj | Totali i Shp. Kapitale | |
| **1** | **Presidenca** | **162,000** | **42,000** | **0** | **0** | **42,000** | **204,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 162,000 | 42,000 | 0 | 0 | 42,000 | 204,000 |
| **2** | **Kuvendi** | **894,000** | **137,000** | **0** | **0** | **137,000** | **1,031,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 894,000 | 137,000 | 0 | 0 | 137,000 | 1,031,000 |
| **3** | **Keshilli Ministrave** | **357,000** | **12,000** | **0** | **0** | **12,000** | **369,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 357,000 | 12,000 | 0 | 0 | 12,000 | 369,000 |
| **4** | **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes** | **1,123,000** | **405,075** | **0** | **1,190,488** | **1,595,563** | **2,718,563** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 335,000 | 26,000 | 0 | 0 | 26,000 | 361,000 |
| 04320 | Mbeshtetje per Energjine | 1,000 | 52,000 | 0 | 146,000 | 198,000 | 199,000 |
| 04430 | Mbeshtetje per Burimet Natyrore | 145,500 | 57,000 | 0 | 0 | 57,000 | 202,500 |
| 04440 | Mbesht. Miniera e Nd/je Publike | 62,000 | 63,000 | 0 | 150,000 | 213,000 | 275,000 |
| 04130 | Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik | 225,500 | 180,075 | 0 | 744,488 | 924,563 | 1,150,063 |
| 04160 | Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr. | 347,000 | 27,000 | 0 | 0 | 27,000 | 374,000 |
| 04770 | Mbeshtetje per Zhvillim Rajonal | 7,000 | 0 | 0 | 150,000 | 150,000 | 157,000 |
| **5** | **Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit** | **4,129,912** | **1,258,947** | **0** | **1,151,979** | **2,410,926** | **6,540,838** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 227,159 | 20,000 | 0 | 0 | 20,000 | 247,159 |
| 04220 | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit | 1,373,644 | 57,198 | 0 | 140,668 | 197,866 | 1,571,510 |
| 04240 | Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes | 730,130 | 918,005 | 0 | 538,016 | 1,456,021 | 2,186,151 |
| 04250 | Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market. | 1,577,334 | 196,366 | 0 | 473,295 | 669,661 | 2,246,995 |
| 04860 | Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor | 208,045 | 67,378 | 0 | 0 | 67,378 | 275,423 |
| 05470 | Menaxhimi qendrueshem i tokes bujqesore | 13,600 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13,600 |
| **6** | **Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit** | **4,880,600** | **58,444,302** | **0** | **12,316,600** | **70,760,902** | **75,641,502** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 303,000 | 6,000 | 0 | 0 | 6,000 | 309,000 |
| 04520 | Rrjeti i rrugeve nacionale | 1,670,100 | 54,350,062 | 0 | 8,707,045 | 63,057,107 | 64,727,207 |
| 04530 | Menaxhimi i Transportit | 24,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 24,000 |
| 04540 | Portet | 65,000 | 166,000 | 0 | 0 | 166,000 | 231,000 |
| 04550 | Hekurudhat | 502,000 | 72,730 | 0 | 0 | 72,730 | 574,730 |
| 04560 | Aviacioni Civil | 73,500 | 26,500 | 0 | 0 | 26,500 | 100,000 |
| 06370 | Ujesjelles-Kanalizime | 948,000 | 3,404,678 | 0 | 2,916,424 | 6,321,102 | 7,269,102 |
| 06180 | Strehimi dhe Urbanistika | 1,141,000 | 280,332 | 0 | 693,131 | 973,463 | 2,114,463 |
| 06220 | Sherbimet publike | 154,000 | 138,000 | 0 | 0 | 138,000 | 292,000 |
| **10** | **Ministria e Financave** | **5,893,600** | **1,660,358** | **0** | **470,700** | **2,131,058** | **8,024,658** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 178,000 | 1,229,662 | 0 | 184,500 | 1,414,162 | 1,592,162 |
| 01120 | Menaxhimi i Shpenzimeve Publike | 379,700 | 4,000 | 0 | 0 | 4,000 | 383,700 |
| 01130 | Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme | 184,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 184,000 |
| 01140 | Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore | 2,013,000 | 121,696 | 0 | 0 | 121,696 | 2,134,696 |
| 01150 | Menaxhimi i te Ardhurave Doganore | 1,370,000 | 303,000 | 0 | 286,200 | 589,200 | 1,959,200 |
| 01160 | Lufta kunder Transaksioneve Financiare Joligjore | 66,900 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 68,900 |
| 10270 | Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore | 1,644,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,644,000 |
| 01180 | Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike | 58,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 58,000 |
| **11** | **Ministria e Arsimit dhe Shkences** | **32,775,500** | **4,135,325** | **1,045,000** | **651,105** | **5,831,430** | **38,606,930** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 904,900 | 65,331 | 0 | 20,000 | 85,331 | 990,231 |
| 09120 | Arsimi Baze (perfshire parashkollorin) | 18,465,600 | 2,655,892 | 0 | 292,297 | 2,948,189 | 21,413,789 |
| 09230 | Arsimi i Mesem (i pergjithshem) | 3,750,000 | 563,732 | 0 | 129,808 | 693,540 | 4,443,540 |
| 09240 | Arsimi i Mesem (profesional) | 2,033,000 | 359,370 | 0 | 40,000 | 399,370 | 2,432,370 |
| 09450 | Arsimi Universitar | 7,462,000 | 491,000 | 1,045,000 | 169,000 | 1,705,000 | 9,167,000 |
| 09770 | Fonde per Shkencen | 160,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 160,000 |
| **12** | **Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve** | **1,500,400** | **548,560** | **0** | **0** | **548,560** | **2,048,960** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 139,500 | 1,800 | 0 | 0 | 1,800 | 141,300 |
| 08220 | Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet | 379,400 | 169,600 | 0 | 0 | 169,600 | 549,000 |
| 08230 | Arti dhe Kultura | 651,000 | 322,832 | 0 | 0 | 322,832 | 973,832 |
| 08140 | Zhvillimi i Sportit | 218,000 | 52,000 | 0 | 0 | 52,000 | 270,000 |
| 08170 | Programe per Rinine | 15,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 15,000 |
| 04760 | Zhvillimi i Turizmit | 97,500 | 2,328 | 0 | 0 | 2,328 | 99,828 |
| **13** | **Ministria e Shendetesise** | **21,789,800** | **2,545,059** | **37,000** | **1,810,193** | **4,392,252** | **26,182,052** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 226,000 | 41,090 | 0 | 0 | 41,090 | 267,090 |
| 07220 | Sherbimet e Kujdesit Paresor | 6,505,000 | 353,417 | 10,000 | 448,181 | 811,598 | 7,316,598 |
| 07330 | Sherbimet e Kujdesit Dytesor | 12,875,200 | 2,085,634 | 20,000 | 1,362,013 | 3,467,647 | 16,342,847 |
| 07450 | Sherbimet e Shendetit Publik | 2,183,600 | 64,918 | 7,000 | 0 | 71,918 | 2,255,518 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **14** | **Ministria e Drejtesise** | **6,078,574** | **250,570** | **0** | **843,751** | **1,094,321** | **7,172,895** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 235,167 | 33,840 | 0 | 232,400 | 266,240 | 501,407 |
| 01120 | Publikimet Zyrtare | 49,872 | 500 | 0 | 0 | 500 | 50,372 |
| 01130 | Mjekesia Ligjore | 46,233 | 4,000 | 0 | 0 | 4,000 | 50,233 |
| 03440 | Sistemi i Burgjeve | 3,165,920 | 197,780 | 0 | 560,000 | 757,780 | 3,923,700 |
| 03350 | Sherbimi i Permbarimit Gjyqesor | 160,620 | 350 | 0 | 0 | 350 | 160,970 |
| 01160 | Sherbimet per çeshtjet e biresimeve | 14,009 | 500 | 0 | 0 | 500 | 14,509 |
| 01170 | Sherbimi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme | 459,000 | 13,600 | 0 | 51,351 | 64,951 | 523,951 |
| 01180 | Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave | 1,947,753 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,947,753 |
| **15** | **Ministria e Puneve te Jashtme** | **1,858,100** | **90,736** | **0** | **0** | **90,736** | **1,948,836** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 52,100 | 4,955 | 0 | 0 | 4,955 | 57,055 |
| 01120 | Perfaqesite Diplomatike | 1,557,000 | 83,890 | 0 | 0 | 83,890 | 1,640,890 |
| 01130 | Promovimi i imazhit te vlerave te vendit | 122,000 | 176 | 0 | 0 | 176 | 122,176 |
| 01140 | Integrimi europian dhe euro-atlantik | 127,000 | 1,715 | 0 | 0 | 1,715 | 128,715 |
| **16** | **Ministria e Brendshme** | **13,476,300** | **913,814** | **58,000** | **916,373** | **1,888,187** | **15,364,487** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 616,184 | 40,000 | 16,000 | 0 | 56,000 | 672,184 |
| 01330 | Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike | 52,625 | 15,000 | 0 | 0 | 15,000 | 67,625 |
| 03140 | Policia e Shtetit | 9,910,163 | 624,046 | 42,000 | 916,373 | 1,582,419 | 11,492,582 |
| 03150 | Garda e Republikes | 1,198,000 | 40,000 | 0 | 0 | 40,000 | 1,238,000 |
| 01160 | Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te P. Vendor | 532,770 | 14,700 | 0 | 0 | 14,700 | 547,470 |
| 01170 | Sherbimi i Gjendjes Civile | 467,968 | 165,068 | 0 | 0 | 165,068 | 633,036 |
| 01180 | Menaxhimi i Rezervave te Shtetit | 94,590 | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 | 99,590 |
| 10910 | Emergjencat Civile | 604,000 | 10,000 | 0 | 0 | 10,000 | 614,000 |
| **17** | **Ministria e Mbrojtjes** | **16,368,000** | **4,212,864** | **100,000** | **600,000** | **4,912,864** | **21,280,864** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,085,000 | 39,000 | 0 | 0 | 39,000 | 1,124,000 |
| 02120 | Forcat e Luftimit | 5,908,000 | 2,930,390 | 0 | 0 | 2,930,390 | 8,838,390 |
| 09430 | Arsimi Ushtarak | 1,284,000 | 326,973 | 0 | 0 | 326,973 | 1,610,973 |
| 07340 | Mbeshtetje Shendetesore | 539,000 | 61,000 | 0 | 600,000 | 661,000 | 1,200,000 |
| 02150 | Mbeshtetja e Luftimit | 3,831,000 | 582,377 | 100,000 | 0 | 682,377 | 4,513,377 |
| 02160 | Mbeshtetja e Perqendruar | 436,000 | 223,000 | 0 | 0 | 223,000 | 659,000 |
| 10270 | Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket | 2,671,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,671,000 |
| 02280 | Bashkepuni Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC) | 614,000 | 50,124 | 0 | 0 | 50,124 | 664,124 |
| **18** | **Sherbimi Informativ Shteteror** | **1,087,100** | **90,420** | **0** | **0** | **90,420** | **1,177,520** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,087,100 | 90,420 | 0 | 0 | 90,420 | 1,177,520 |
| **19** | **Drejtoria e Radio Televizionit** | **439,000** | **100,000** | **0** | **0** | **100,000** | **539,000** |
| 08310 | Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti | 349,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 349,000 |
| 08520 | Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja | 0 | 100,000 | 0 | 0 | 100,000 | 100,000 |
| 08330 | Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare | 50,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 50,000 |
| 08340 | Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise | 40,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 40,000 |
| **20** | **Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave** | **149,000** | **21,000** | **0** | **0** | **21,000** | **170,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 149,000 | 21,000 | 0 | 0 | 21,000 | 170,000 |
| **22** | **Akademia e Shkences** | **82,800** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **84,800** |
| 01510 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 82,800 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 84,800 |
| **24** | **Kontrolli Larte  i Shtetit** | **276,000** | **9,000** | **0** | **0** | **9,000** | **285,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 276,000 | 9,000 | 0 | 0 | 9,000 | 285,000 |
| **25** | **Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta** | **42,788,200** | **55,500** | **5,000** | **21,292** | **81,792** | **42,869,992** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 129,930 | 3,000 | 0 | 0 | 3,000 | 132,930 |
| 10220 | Sigurimi Shoqeror | 22,809,250 | 2,000 | 0 | 21,292 | 23,292 | 22,832,542 |
| 10430 | Mbrojtja Sociale | 18,186,800 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18,186,800 |
| 10550 | Tregu i Punes | 1,501,270 | 50,500 | 5,000 | 0 | 55,500 | 1,556,770 |
| 04170 | Inspektimi ne Pune | 149,500 | 0 | 0 | 0 | 0 | 149,500 |
| 10460 | Shanset e Barabarta | 11,450 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11,450 |
| **26** | **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave** | **1,138,900** | **256,600** | **50,000** | **485,834** | **792,434** | **1,931,334** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 72,000 | 3,600 | 0 | 0 | 3,600 | 75,600 |
| 05320 | Programe per mbrojtjen e Mjedisit | 104,000 | 17,500 | 0 | 204,000 | 221,500 | 325,500 |
| 04230 | Mbeshtetje per Peshkimin | 62,000 | 60,500 | 0 | 10,776 | 71,276 | 133,276 |
| 05640 | Administrimi i Ujrave | 29,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29,000 |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve | 871,900 | 175,000 | 50,000 | 271,058 | 496,058 | 1,367,958 |
| **28** | **Prokuroria e Pergjithshme** | **1,138,000** | **48,000** | **0** | **0** | **48,000** | **1,186,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,138,000 | 48,000 | 0 | 0 | 48,000 | 1,186,000 |
| **29** | **Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor** | **1,474,000** | **164,350** | **0** | **0** | **164,350** | **1,638,350** |
| 03310 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 1,474,000 | 164,350 | 0 | 0 | 164,350 | 1,638,350 |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **94,760** | **4,000** | **0** | **0** | **4,000** | **98,760** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 94,760 | 4,000 | 0 | 0 | 4,000 | 98,760 |
| **31** | **Agjensia Telegrafike Shqiptare** | **91,000** | **2,000** | **0** | **3,000** | **5,000** | **96,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 91,000 | 2,000 | 0 | 3,000 | 5,000 | 96,000 |
| **40** | **Partite Politike** | **200,000** | **0** | **0** | **0** | **0** | **200,000** |
| 01110 | Mbeshtetje per Partite Politike | 192,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 192,000 |
| 01120 | Mbeshtetje per Shoqatat | 5,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5,000 |
| 01130 | Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status | 3,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3,000 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **50** | **Instituti Statistikes** | **203,700** | **5,000** | **0** | **5,000** | **10,000** | **213,700** |
| 01310 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 203,700 | 5,000 | 0 | 5,000 | 10,000 | 213,700 |
| **53** | **Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 04110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **55** | **Shkolla e Magjistratures** | **55,900** | **1,000** | **0** | **0** | **1,000** | **56,900** |
| 03310 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 55,900 | 1,000 | 0 | 0 | 1,000 | 56,900 |
| **56** | **Fondi i Zhvillimit Shqiptar** | **0** | **700,000** | **0** | **2,067,199** | **2,767,199** | **2,767,199** |
| 06210 | Programe Zhvillimi | 0 | 700,000 | 0 | 2,067,199 | 2,767,199 | 2,767,199 |
| **57** | **Qendra Kombetare e Kinematografise** | **131,100** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **133,100** |
| 08210 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 131,100 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 133,100 |
| **59** | **Instituti i Integrimit te Perndjekurve Politik** | **26,200** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **28,200** |
| 01110 | Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik | 26,200 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 28,200 |
| **63** | **Keshilli i Larte i Drejtesise** | **77,100** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **79,100** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 77,100 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 79,100 |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **85,700** | **5,000** | **0** | **0** | **5,000** | **90,700** |
| 03310 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 85,700 | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 | 90,700 |
| **67** | **Komisioni i Sherbimit Civil** | **46,300** | **1,000** | **0** | **0** | **1,000** | **47,300** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 46,300 | 1,000 | 0 | 0 | 1,000 | 47,300 |
| **73** | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | **693,800** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **695,800** |
| 01610 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 93,800 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 95,800 |
| 01620 | Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale | 600,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 600,000 |
| **76** | **Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive** | **90,600** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **92,600** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 90,600 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 92,600 |
| **77** | **Autoriteti i Konkurences** | **58,500** | **3,000** | **0** | **0** | **3,000** | **61,500** |
| 04110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 58,500 | 3,000 | 0 | 0 | 3,000 | 61,500 |
| **78** | **Ministria e Integrimit** | **154,750** | **5,250** | **0** | **0** | **5,250** | **160,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 46,000 | 3,650 | 0 | 0 | 3,650 | 49,650 |
| 01140 | Drejtesia dhe Tregu i Brendshem | 27,000 | 800 | 0 | 0 | 800 | 27,800 |
| 01150 | Mbeshtetja Institucionale per Procesin e Integrimit | 81,750 | 800 | 0 | 0 | 800 | 82,550 |
| **82** | **Keshilli Kombetar i Kontabilitetit** | **14,100** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **16,100** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 14,100 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 16,100 |
| **86** | **Avokati i Prokurimeve** | **26,000** | **2,000** | **0** | **0** | **2,000** | **28,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 26,000 | 2,000 | 0 | 0 | 2,000 | 28,000 |
| **87** | **Institucione te tjera Qeveritare** | **262,000** | **354,183** | **0** | **80,000** | **434,183** | **696,183** |
| 01320 | Sherbime Qeveritare | 80,000 | 79,483 | 0 | 0 | 79,483 | 159,483 |
| 01130 | Sherbimi i Prokurimit Publik | 67,000 | 69,700 | 0 | 0 | 69,700 | 136,700 |
| 01140 | Sherbime per shoqerite e informacionit | 45,000 | 197,000 | 0 | 80,000 | 277,000 | 322,000 |
| 01150 | Sherbime te tjera | 70,000 | 8,000 | 0 | 0 | 8,000 | 78,000 |
| **88** | **Mbeshtetje per Shoqerine Civile** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **89** | **Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale** | **46,000** | **5,000** | **0** | **0** | **5,000** | **51,000** |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 46,000 | 5,000 | 0 | 0 | 5,000 | 51,000 |

***ne 000/leke***

| **Grupet** | **Institucionet e Pavarura** | **Nr. Punonjesve** | **Buxheti Total** |
|---|---|---|---|
| 1 | Presidenca | 80 | 204,000 |
| 2 | Kuvendi | 477 | 1,031,000 |
| 24 | Kontrolli i Larte i Shtetit | 160 | 285,000 |
| 28 | Prokuroria e Pergjithshme | 807 | 1,186,000 |
| 29 | Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor | 1,230 | 1,638,350 |
| 30 | Gjykata Kushtetuese | 50 | 98,760 |
| 55 | Shkolla e Magjistratures | 22 | 56,900 |
| 63 | Keshilli i Larte i Drejtesise | 41 | 79,100 |
| 66 | Avokati i Popullit | 50 | 90,700 |
| 67 | Komisioni i Sherbimit Civil | 28 | 47,300 |
| 73 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 60 | 695,800 |
| 76 | Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive | 45 | 92,600 |
| 77 | Autoriteti i Konkurences | 35 | 61,500 |
| 86 | Avokati i Prokurimeve | 15 | 28,000 |
| 89 | Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale | 30 | 51,000 |

## TREGUESIT FISKALE TE BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2009 (AN)
## (FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2009 NA)

| Nr. | E M E R T I M I | Buxheti 2009 | Ne % te PBB | Buxheti Rishikuar 2009 | Ne % te PBB | Akt Normativ 2009 | Ne % te PBB | Diferenca absolute |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **334,823** | **28.5%** | **326,117** | **27.7%** | **319,893** | **27.2%** | **-6,224** |
| **I.** | **Te ardhura nga ndihmat** | **6,313** | **0.5%** | | 0.0% | | **0.0%** | **0** |
| | Nga kjo:Mbeshtetje buxhetore(Gerdec) | | 0.0% | **6,313** | 0.54% | **6,313** | 0.5% | **0** |
| **II.** | **Te ardhura tatimore** | **305,988** | **26.1%** | **294,982** | **25.1%** | **288,057** | **24.5%** | **-6,925** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **230,168** | **19.6%** | **222,669** | **18.9%** | **219,444** | **18.7%** | **-3,225** |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 117,491 | 10.0% | 114,657 | 9.7% | 112,657 | 9.6% | -2,000 |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 20,813 | 1.8% | 17,559 | 1.5% | 17,559 | 1.5% | -1 |
| 3 | Akcizat | 44,363 | 3.8% | 36,795 | 3.1% | 36,571 | 3.1% | -225 |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 26,065 | 2.2% | 30,611 | 2.6% | 29,611 | 2.5% | -1,000 |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 15,312 | 1.3% | 15,210 | 1.3% | 15,210 | 1.3% | 0 |
| 6 | Taksa Doganore | 6,124 | 0.5% | 7,837 | 0.7% | 7,837 | 0.7% | 0 |
| **II.2** | **Te ardhura nga Pushteti Vendor** | **18,412** | **1.6%** | **18,412** | **1.6%** | **18,412** | **1.6%** | **0** |
| 1 | Taksa Lokale | 11,114 | 0.9% | 11,114 | 0.9% | 11,114 | 0.9% | 0 |
| 2 | Tatimi mbi Pasurine(ndertesat) | 3,734 | 0.3% | 3,734 | 0.3% | 3,734 | 0.3% | 0 |
| 3 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 3,564 | 0.3% | 3,564 | 0.3% | 3,564 | 0.3% | 0 |
| **II.3** | **Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)** | **57,408** | **4.9%** | **53,901** | **4.6%** | **50,201** | **4.3%** | **-3,700** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 51,029 | 4.3% | 47,522 | 4.0% | 44,322 | 3.8% | -3,200 |
| 2 | Sigurimi Shendetesor | 6,379 | 0.5% | 6,379 | 0.5% | 5,879 | 0.5% | -500 |
| **III.** | **Te ardhura Jotatimore** | **22,522** | **1.9%** | **24,822** | **2.1%** | **25,522** | **2.2%** | **700** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 5,700 | 0.5% | 5,700 | 0.5% | 5,700 | 0.5% | 0 |
| 2 | Te ardhura nga Institucionet Buxhetore | 11,857 | 1.0% | 11,857 | 1.0% | 11,857 | 1.0% | 0 |
| 3 | Dividenti | 165 | 0.0% | 165 | 0.0% | 165 | 0.0% | 0 |
| 4 | Tarifat e Sherbimeve | 3,800 | | 3,800 | 0.3% | 3,800 | | 0 |
| 5 | Te tjera | 1,000 | 0.1% | 3,300 | 0.3% | 4,000 | 0.3% | 700 |
| | *Nga e cila: Arketime nga detyrime te KESH/OST* | | | *2,300* | *0.2%* | *2,300* | | *0* |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **384,834** | **32.8%** | **400,908** | **34.1%** | **401,512** | **34.1%** | **605** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **283,698** | **24.2%** | **285,469** | **24.3%** | **285,979** | **24.3%** | **510** |
| **1** | **Personeli** | **59,651** | **5.1%** | **59,547** | **5.1%** | **59,792** | **5.1%** | **245** |
| | Paga | 51,563 | 4.4% | 51,460 | 4.4% | 51,677 | 4.4% | 217 |
| | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 8,088 | 0.7% | 8,087 | 0.7% | 8,115 | 0.7% | 28 |
| | Politikat e reja pagash | | 0.0% | | 0.0% | | | |
| **2** | **Interesat** | **36,040** | **3.1%** | **36,740** | **3.1%** | **36,726** | **3.1%** | **-14** |
| | Te Brendshme | 31,420 | 2.7% | 31,420 | **2.7%** | 31,420 | 2.7% | 0 |
| | Te Huaja | 4,620 | 0.4% | 5,320 | **0.5%** | 5,306 | 0.5% | -14 |
| **3** | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **35,813** | **3.1%** | **34,698** | **2.9%** | **34,802** | **3.0%** | **104** |
| **4** | **Subvencionet** | **2,022** | **0.2%** | **2,022** | **0.2%** | **2,022** | **0.2%** | **0** |
| **5** | **Shpenzime per Sig.Shoq e Shendet** | **95,866** | **8.2%** | **95,866** | **8.1%** | **95,651** | **8.1%** | **-215** |
| | Sigurime Shoqerore | 71,655 | 6.1% | 71,655 | 6.1% | 71,440 | 6.1% | -215 |
| | Sigurime Shendetesore | 24,211 | 2.1% | 24,211 | 2.1% | 24,211 | 2.1% | 0 |
| **6** | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | **36,835** | **3.1%** | **36,835** | **3.1%** | **36,835** | **3.1%** | **0** |
| | Buxheti lokal (Granti) | 18,423 | 1.6% | 18,423 | 1.6% | 18,423 | 1.6% | 0 |
| | Buxheti lokal (Te ardhurat e veta) | 18,412 | 1.6% | 18,412 | 1.6% | 18,412 | 1.6% | 0 |
| **7** | **Shpenzime te tjera** | **16,871** | **1.4%** | **17,991** | **1.5%** | **18,381** | **1.6%** | **390** |
| | Pagesa e Papunesise | 1,000 | 0.1% | 950 | 0.1% | 885 | 0.1% | -65 |
| | Ndihma Ekonomike | 13,871 | 1.2% | 13,871 | 1.2% | 14,326 | 1.2% | 455 |
| | Kompensim per ish te perndjekurit politike | 2,000 | 0.2% | 3,170 | 0.3% | 3,170 | 0.3% | -1 |
| | Kompensim per energjine elektrike | | 0.0% | | 0.0% | | 0.0% | 0 |
| **8** | **Kompensim ne vlere i pronareve** | **600** | **0.1%** | **1,770** | **0.2%** | **1,770** | **0.2%** | **0** |
| **II.** | **Fondi Rezerve, Kontigjenca** | **15,700** | **1.3%** | **14,921** | **1.3%** | **15,122** | **1.3%** | **201** |
| | Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave | 2,000 | 0.2% | 2,600 | 0.2% | 2,600 | 0.2% | 0 |
| | Fondi Kontigjence per Politika Pagash dhe Pensionesh | 7,700 | 0.7% | 7,700 | 0.7% | 7,700 | 0.7% | 0 |
| | Fondi Kontigjence per ruajtjen e deficitit | 6,000 | 0.5% | 4,621 | 0.4% | 4,822 | 0.4% | 201 |
| **IV** | **Shpenzime Kapitale** | **90,436** | **7.7%** | **100,518** | **8.5%** | **100,411** | **8.5%** | **-107** |
| | Financimi Brendshem | 68,661 | 5.8% | 80,962 | 6.9% | 77,797 | 6.6% | -3,165 |
| | Financimi Huaj | 21,775 | 1.9% | 19,556 | 1.7% | 22,614 | 1.9% | 3,058 |
| **V** | **Net Lending KESH** | **-5,000** | **-0.4%** | **0** | **0.0%** | | **0.0%** | **0** |
| | **DEFIÇITI** | **-50,011** | **-4.3%** | **-74,791** | **-6.4%** | **-81,620** | **-6.9%** | **-6,829** |
| | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **50,011** | **4.3%** | **74,792** | **6.4%** | **81,620** | **6.9%** | **6,828** |
| | **Brendshem** | **41,699** | **3.6%** | **68,218** | **5.8%** | **71,119** | **6.0%** | **2,901** |
| | Te ardhura nga privatizimi | 200 | 0.0% | 27,794 | 2.4% | 27,794 | 2.4% | 0 |
| | Hua-marrje e brendshme | 41,499 | 3.5% | 40,424 | 3.4% | 43,325 | 3.7% | 2,901 |
| | Te tjera | | 0.0% | | 0.0% | | 0.0% | 0 |
| | **I Huaj** | **8,312** | **0.7%** | **6,574** | **0.56%** | **10,501** | **0.9%** | **3,927** |
| | Hua afatgjate (e marre) | 15,462 | 1.3% | 13,244 | 1.1% | 16,301 | 1.4% | 3,057 |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | | | | 0.0% | | 0.0% | 0 |
| | Ripagesat | -7,150 | -0.6% | -6,670 | -0.6% | -5,800 | -0.5% | 870 |
| | Mbeshtetje buxhetore | | | | | | | |
| | **Produkti i Brendshem Bruto (PBB) 2009** | **1,173,800** | | **1,176,349** | **100%** | **1,176,349** | **100%** | **0** |

**VENDIM**
**Nr.1182, datë 3.12.2009**

## PËR HAPJEN E INSTITUTIT TË STUDIMEVE EUROPIANE NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, 10, e 41, pika 5, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Institutit të Studimeve Europiane (ISE), si njësi kryesore, ndërfakultetore, në Universitetin e Tiranës (UT).

2. Instituti i Studimeve Europiane ka për mision:

a) organizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit;

b) organizimin dhe ofrimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë;

c) ofrimin e shërbimeve për të tretë dhe konsulenca në fushën e studimeve europiane.

3. Instituti i Studimeve Europiane ka si qëllim të veprimtarisë të tij përgatitjen dhe formimin e vazhduar të specialistëve shqiptarë, në kuadër të proceseve integruese drejt Bashkimit Europian dhe më gjerë.

4. Njësitë bazë të Institutit të Studimeve Europiane janë departamentet, si më poshtë vijon:

a) Politika dhe qeverisje;

b) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare;

c) Legjislacioni dhe institucionet europiane.

5. Struktura dhe mënyra e organizimit të Institutit të Studimeve Europiane përcaktohen në statutin e Universitetit të Tiranës, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

6. Burimet njerëzore, kapacitetet për mësim dhe kërkim, si dhe mjetet e nevojshme financiare sigurohen nga Universiteti i Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1203, datë 11.12.2009**

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KALIMASH-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 407 (katërqind e shtatë) $m^2$ tokë truall, me vlerë 823 361 (tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, për objekte, me vlerë 28 791 625.25 (njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë pikë njëzet e pesë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 256 000 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.12.2009 dhe të përfundojë më 15.3.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për objektet, pronarët, përveç dokumentacionit të pronësisë, duhet të paraqesin dhe dokumentacionin tekniko–ligjor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë. Për objektet, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, në bazë të dokumentacionit ligjor të pronësisë dhe në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KALIMASH-MORINË"

| Nr. | Pronari | | | Zk | Nr.pas | Truall | | | Objekte vlera lekë | Totali lekë | Vendndodhja | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | Sip.$m^2$ | Çmimi $m^2$ | Vlera lekë | | | | |
| 1 | Abedin | Rasim | Oruçi | 1543 | 157/2;157/3 | 292 | 2023 | 590716 | 25757107 | 26347823 | Lagjja drinas | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | Habibe | Ahmet | Oruçi | 1543 | 157/4 | 115 | 2023 | 232645 | | 232645 | Lagjja drinas | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3 | Bashkim | Selman | Cenaj | 2315 | 41/28 | | | | 306238 | 306238 | Qytet kukës | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4 | Vesel | Adem | Dida | 1176 | 297/4 | | | | 2728280.25 | 2728280.25 | Breg-lum | Konfirmuar nga ZRPP |
| | **Totali** | | | | | **407** | | **823361** | **28791625.25** | **29614986.25** | | |

**VENDIM**
**Nr.1205, datë 11.12.2009**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE DHE PËR DEGËN E DOGANËS, FIER, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të degës së doganës, Fier të përfundojnë, brenda datës 15 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit, me objekte "Ofrimi i shërbimeve me rojë private" dhe "Shtesë kati dhe rikonstruksion i zyrave të degës së doganës, Fier", me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2009. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1207, datë 11.12.2009**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS NGA KOPSHTI ZOOLOGJIK NË TAKIM ME RRUGËN "SAMI FRASHËRI", NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga rikonstruksioni i rrugës nga Kopshti Zoologjik në takim me rrugën "Sami Frashëri", në bashkinë e Tiranës.

2. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që jepet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 44(dyzet e katër) m² tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 052 336 (dy milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 052 336 (dy milionë e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e vitit 2009.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Tiranës.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Tiranës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë, 44(dyzet e katër) m², tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS NGA KOPSHTI ZOOLOGJIK NË TAKIM ME RRUGËN "SAMI FRSHËRI", NË BASHKINË E TIRANËS

| Nr. | Emër, mbiemër | Sipërfaqja truall m² | Çmimi lekë | Vlera lekë | Dokumenti i pronësisë | Zona e kadastrave |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Naim Tarja | 44 | 46 644 | 2 052 336 | Vërtetim pronësie | 8270 |
| | **Totali** | **44** | | **2 052 336** | | |
| | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr.1208, datë 11.12.2009**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I SHESHIT "SHTRAUS", NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i sheshit "Shtraus", në bashkinë e Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas masës përkatëse, që jepet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) m² truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 280 304 (katër milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 4 280 304 (katër milionë e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e katër) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet po nga bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) m² truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Proces regjistrimi", të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Tiranës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Tiranës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR "RISTRUKTURIMIN E SHESHIT "SHTRAUS"", NË BASHKINË E TIRANËS

| **Nr.** | **Emër, mbiemër** | **Sipërfaqja $m^2$** | **Çmimi lekë $m^2$** | **Vlera lekë** | **Dokumenti i pronësisë** | **Zona kadastrale** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bajram Shanku | 132 | 25 478 | 3 363 096 | Proces | 8140 |
| 2 | Shpresa Çaka | 36 | 25 478 | 917 208 | Vërtetim pronësie | 8140 |
| | **Totali** | **168** | | **4 280 304** | | |

## VENDIM
## Nr.1210, datë 11.12.2009

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KUMAN TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kuman të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 29 (njëzet e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 122 (njëqind e njëzet e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i komunës Kuman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Kuman                                                                 Lidhja nr. 1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 1-3,121 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 4-14 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e Mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 5-22,122 | Prona që përdoren për realizmin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 23-26 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 27-30 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 31-40 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 42,46,48 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim |
| 43,44,45,47,49,51,56,65,78,87,89,93 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta) | Në pronësi |
| 94-107 | Infrastrukturë (Rrugë vendore) | Në pronësi |
| 108-112 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. | Në pronësi |

## VENDIM
## Nr.1211, datë 11.12.2009

## PËR MIRATIMIN E KUOTAVE SHTESË TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE "MASTER I NIVELIT TË DYTË", NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 170 kuotave shtesë për pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë, "Master i nivelit të dytë" (MND), në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010.

2. Kuotat shtesë të pranimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahen në universitetet, fakultetet dhe programet përkatëse të studimit, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kuotat e paplotësuara në programet e studimeve të ciklit të tretë, "Master i nivelit të dytë", në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Tabela 1: Shpërndarja e kuotave shtesë të pranimit në MND, sipas universiteteve dhe programeve përkatëse të studimit

A. UNIVERSITETI I TIRANËS

| Nr. | Programi i studimit të MND-së | Fakulteti | Kuota |
|---|---|---|---|
| 1 | Shkenca juridike civile | Fakulteti i drejtësisë | 50 |
| 2 | Shkencat penale | “ | 50 |
| 3 | E drejta kushtetuese, e krahasuar dhe europiane | “ | 50 |

B. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

| Nr. | Programi i studimit të MND-së | Fakulteti | Kuota |
|---|---|---|---|
| 1 | Teknologji mjedisi | Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit | 10 |
| 2 | Menaxhimi i resurseve dhe përmirësimi gjenetik i bimëve | “ | 10 |

**VENDIM**
**Nr.1212, datë 11.12.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË DHE ARSIMIN E MESËM, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë” në:

a) “Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte”;

b) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte”;

c) “Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi”;

ç) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndën histori”;

d) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe “Master i nivelit të parë”, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| a) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte | 50; |
| b) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte | 50; |
| c) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi | 60; |
| ç) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori | 60; |
| d) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi | 60. |

5. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| a) “Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte” | 40 000 lekë; |
| b) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte” | 45 000 lekë; |
| c) “Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi” | 40 000 lekë; |
| ç) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori” | 45 000 lekë; |
| d) “Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”. | 45 000 lekë. |

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 4, të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1232, datë 11.12.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE PËR PËRJASHTIMET NGA DETYRIMI PËR NJOFTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, QË PËRPUNOHEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rasteve, për të cilat njoftimi për përpunimin e të dhënave personale, pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk është i nevojshëm, si më poshtë vijon:

a) Kur përpunimi i këtyre të dhënave kryhet nga organizatat jofitimprurëse politike, sindikaliste, fetare ose filozofike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave;

b) Kur përpunimi i këtyre të dhënave lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat, në ushtrimin e të drejtave e të detyrimeve, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, dalë në zbatim të tyre, nëse përpunimi kufizohet në:

i) qëllimin e pranimit në punë;
ii) aplikimet;
iii) konkurrimet;
iv) emërimet;
v) largimet nga detyra;
vi) ngritjet në detyrë;
vii) vlerësimet e rezultateve të punës;
viii) masat disiplinore;
ix) regjistrin e personelit;
x) kualifikimet;
xi) të dhënat në kontratën e punës;
xii) përllogaritjet e pagave.

Të dhënat sensitive, që mund të përpunohen për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në shkronjën"b" të pikës 1 të këtij vendimi, janë të detyrueshme të njoftohen.

c) Kur përpunimi i të dhënave bëhet në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", por kufizohet në përmbushjen e qëllimeve të nevojshme, në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

2. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1234, datë 16.12.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT DHE TË ELEMENTEVE TË NJOFTIMIT PËR BARRËN SIGURUESE DHE/OSE BARRËN HIPOTEKORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 91 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekore, mbi masën e sigurimit të detyrimit tatimor, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**
**Drejtoria rajonale tatimore**
**Drejtoria e mbledhjes**

Nr.. prot, datë më,...,....09

Format

NJOFTIM I PËRGJITHSHËM PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE DHE HIPOTEKORE

Nga: Drejtoria rajonale tatimore_________________
Adresa__________________
Njoftim për publikun e interesuar

1. Mbështetur në pikën 5 të nenit 91 të këtij ligji nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtoria rajonale_________ka vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit:

Tatimpaguesi:___________;
NIPT: ___________;
Adresa e biznesit___________.

2. Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

| **Lloji i tatimit** | **Shuma e tatimit** | **Interesa deri në këtë moment** | **Gjoba** | **Gjithsej Detyrime tatimore** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

3. Tatimpaguesit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

4. Ky dokument përfaqëson barrën siguruese dhe hipotekore në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoria rajonale---------. mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (tatime, gjoba dhe interes). Vendosja e kësaj barre hipotekore synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Ky dokument synon të njoftojë të gjitha palët që kanë interesa me këtë tatimpagues.

Në________, më________, dita e________, ora________
Firma e Drejtorit rajonal të tatimeve
Vula e institucionit

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**
**Drejtoria rajonale tatimore**
**Drejtoria e mbledhjes**

Nr.. prot, datë më,...,....09

Format

NJOFTIM I PËR VENDOSJEN E BARRËS HIPOTEKORE

Nga: Drejtoria rajonale tatimore___________
Adresa___________
Për: Zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme
Adresa:
Për njoftim: Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Adresa:

1. Mbështetur në pikën 5 të nenit 91 të këtij ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria rajonale___________, ka vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit:

Tatimpaguesi: ___________;
NIPT: ___________;
Adresa e biznesit___________.

2. Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si vijon:

| **Lloji i tatimit** | **Shuma e tatimit** | **Interesa deri në këtë moment** | **Gjoba** | **Gjithsej Detyrime tatimore** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

3. Tatimpaguesit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim për pagimin e detyrimit”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

4. Ky dokument përfaqëson barrën hipotekore në favor të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoria rajonale________ mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasin këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara

në afatin e kërkuar prej tij (tatime, gjoba dhe interes). Vendosja e kësaj barre hipotekore synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Drejtoria rajonale_____ka identifikuar këto pasuri të paluajtshme të tatimpaguesit____me NIPT___________:

5.1___________________________________________

5.2___________________________________________

5.3___________________________________________

Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, brenda 5 ditëve pune duhet të bëni identifikimin e këtyre pasurive dhe vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës tatimore, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jetë shlyer.

Në_________, më________, dita e________, ora________

Firma e drejtorit rajonal të tatimeve

Vula e institucionit

**VENDIM**
**Nr.1239, datë 16.12.2009**

## PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të pikës 17 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Pagesa për personat me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre bëhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin përfituesi ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.".

2. Shkronja "b" e pikës 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Certifikatën personale ose kopjen e letërnjoftimit.".

3. Shkronja "a" e pikës 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

" a) Kopje të letërnjoftimit, të personit kujdestar;".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1241, datë 16.12.2009**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË "BIBLIOTEKËS SË KADAREVE" GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit të "Bibliotekës së Kadareve", Gjirokastër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Gjirokastër.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 144 (njëqind e dyzet e katër) m² truall dhe 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim 3-katësh, me çmim 11 938 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë/ m², vlerësuar në shumën e përgjithshme 5 367 480 (pesë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.
5. Shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
7. Punimet për realizimin e projektit të përfundojnë brenda datës 31.3.2010.
8. Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme, në emër të drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Gjirokastër, i përbërë nga 144 ( njëqind e dyzet e katër) m² truall dhe 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim 3-katësh, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe drejtoria rajonale e kulturës kombëtare, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR RESTAURIMIN E "SHTËPISË SË KADARESË" DHE KTHIMIN E SAJ NË INTERES PUBLIK

Rrethi Gjirokastër
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet:truall dhe banesë 3-katëshe
Shpronësim definitiv

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. kadastral | Nr. Pasurisë | Sip. e shpronësuar në m² | Çmimi në lekë/m² | Adresa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Grigor(Gole) | Pavli | Vasho | Truall dhe banesë 3-katëshe | 8542 | 3/5 | 144 dhe 96 | 11.938 | Gjirokastër |

**VENDIM**
**Nr.1246, datë 23.12.2009**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA RAJONALE RRUGORE, LEZHË, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e drejtorisë rajonale rrugore, Lezhë të përfundojë, brenda datës 31 dhjetor 2009, si autoritet kontraktor, procedurat e prokurimit për investime "Riveshje pjesore, Ura e Fanit-Autostradë" dhe "Riveshje pjesore, Kakarriq", me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse e publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe drejtoria rajonale rrugore, Lezhë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Aneksi 1

| **Nr.** | **Objekti i prokurimit** | **Autoriteti kontraktor** |
|---|---|---|
| 1 | Riveshje pjesore ura e fanit-autostradë | Drejtoria rajonale rrugore,Lezhë |
| 2 | Riveshje pjesore kakarriq | Drejtoria rajonale rrugore, Lezhë |

**VENDIM**
**Nr.1248, datë 11.12.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.28, DATË 24.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 65 e 66 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën "b" të pikës 1 të vendimit nr.28, datë 24.1.2007 të Këshillit të Ministrave, në listën e ekspertëve të fushës së arsimit të lartë, shkencës, teknologjisë dhe sektorit privat, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- "Prof.Dr.Bardhyl Musai zëvendësohet me Prof.Dr.Gëzim Karapici, në cilësisë e anëtarit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.".

- “Prof.Dr.Myqerem Tafaj zëvendësohet me Prof.Dr.Pavli Kongo, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## UDHËZIM
## Nr.2306, datë 10.12.2009

## PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2365, DATË 26.11.2008 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.277,D ATË 18.6.1997 “PËR PËRFITIMIN NGA STATUSI I TË VERBRIT”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar”, bëhen këto ndryshme:

1. Germa “a” e pikës 2, ndryshon si më poshtë:

“a”Certifikatë personale ose kopje të letërnjoftimit, e cila ripërtërihet çdo fillim viti.

2. Germa “f” e pikës 2, ndryshon si më poshtë:

“f” Kopje e noterizuar e letërnjoftimit, kur kujdestari është i zgjedhur jashtë familjes.

3. Përmbajtja e pikës 17 ndryshohet si më poshtë:

“17 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror pajis me librezën e re të verbërisë të gjithë personat e verbër. Afati i vlefshmërisë së librezës është në përputhje me afatin e komisionimit, të përcaktuar në vendimin e KMPV-së”.

4. Në pikën e 20 të udhëzimit, pas togfjalëshit “certifikatë personale me fotografi...” shtohet togfjalëshi: “...ose kopje të letërnjoftimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
**Spiro Ksera**

**UDHËZIM**
**Nr.1547/1, datë 11.12.2009**

**PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.1547, DATË 27.8.2009 "PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR"**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1547, datë 27.8.2009 "Për nivelin e kuotës së shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror", bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 2, pas germës "c" shtohet germa "d" me këtë përmbajtje:

"d në shtëpitë e fëmijëve 3-15 vjeç 200 lekë.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
**Spiro Ksera**

**VENDIM**
**Nr.85, datë 14.12.2009**

**PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË DISA KARTËMONEDHAVE ME KURS LIGJOR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4 shkronja "b", të nenit 40, pika 5, të nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të kreut II të udhëzimit "Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi i parasë", miratuar me vendimin nr.27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të kreut II pika 5 të rregullores "Për funksionimin e Departamentit të Emisionit", miratuar me vendimin nr. 21, datë 28.3.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave me kurs ligjor si më poshtë:

a) Kartëmonedha prerje 500 lekë, emetim i vitit 1991,1992,1993,1996,1997, imazhi lule dielli; dhe

b) Kartëmonedha prerje 500 lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit.

2) Kartëmonedhat me prerjet dhe emetimet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të kenë kurs ligjor deri në datën 30.6.2010.

3. Kartëmonedhat me kurs ligjor sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi do të mblidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim deri në datën 31.12.2012.

4. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim deri në datën 31.12.2012, kartëmonedhat me kurs ligjor sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi dhe t'i dërgojnë ato menjëherë pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saj.

5. Ngarkohet Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
**Ardian Fullani**

**KËRKESË**
**Nr.6417/5, datë 10.12.2009**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Lidhja e rrugës hyrëse Kombinat me Urën e re Berat”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se kjo shpallje kërkese për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit truall dhe objekte.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Ndërsa në kolonën e objekteve është bërë shënimi “proces legalizimi”. Këta persona do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të jetë kryer legalizimi nga institucionet përkatëse.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 22 930 476 (njëzet e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
**Sokol Olldashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E TROJEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LIDHJA E RRUGËS HYRËSE KOMBINAT ME URËN E RE BERAT"

| | | Pronari | | | Nr. | | Tokë truall | | Vlera | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Zk | Pas. | Sip.$m^2$ | Çmimi lekë/$m^2$ | Vlera lekë | Totale lekë | Shënime |
| 1 | Fitime | | Molishti | 8501 | 10/263 | 550 | 3100 | 1705000 | 1705000 | Konf zrpp |
| 2 | B/pronarët | | Drenova | 8501 | 10/189 | 1041 | 3100 | 3227100 | 3227100 | Konf zrpp |
| 3 | B/pronarët | | Drenova | 8501 | 10/185 | 143 | 3100 | 443300 | 443300 | Konf zrpp |
| 4 | Kamber | | Hasani | 8501 | 9/194 | 140 | 3100 | 434000 | 434000 | Konf zrpp |
| | | **Shuma** | | | | **1874** | | **5809400** | **5809400** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"HYRJE-BERAT"

| Nr. | Emri | Pronari | | | Nr.pas. | Vlera | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Atësia | Mbiemri | Zk | | Totale lekë | Shënime |
| 1 | Kamber | | Hasani | 8501 | 9/194 | 661 1687 | Konf ZRPP |
| 2 | Shpëtim | | Zanaj | 8501 | 10/35 | 1097745 | Konf ZRPP |
| 3 | Lulzim | | Balla | 8501 | 11/13 | 577350 | Konf ZRPP |
| 4 | Klei | Edison | Çobo | 8501 | | 3444659 | Në proces legalizimi |
| 5 | Ali | | Hasani | 8501 | | 2166724 | Në proces legalizimi |
| 6 | Rushit | | Azizi | 8501 | | 1327105 | Në proces legalizimi |
| 7 | Ylmi | | Dushku | 8501 | | 324536 | Në proces legalizimi |
| 8 | Robert | | Çela | 8501 | | 1571270 | Në proces legalizimi |
| | **Shuma** | | | | | **17121076** | |

**KËRKESË**
**Nr.7222, datë 10.12.2009**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i "Kalatës së Limjonit Sarandë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është sh.a.porti Sarandë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 7 321 870 (shtatë milionë e treqind e e njëzet e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë.

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË KALATËS SË LIMJONIT SARANDË

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona kadastrale | Nr.pasurisë | Ndërtesë sip $m^2$ | Çmimi lekë/$m^2$ | Vlera lekë/$m^2$ | Truall $m^2$ | Çmimi lekë/$m^2$ | Vlera lekë | Vlera totale lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Niko | Spiro | Lloja | 8641 | 1 | 100 | | | | | 4 533 550 | 4 533 550 |
| 2. | Niko | Spiro | Lloja | 8641 | 1 | | | | 160 | 17.427 | 2 788 320 | 2 788 320 |
| Shuma | Niko | Spiro | Lloja | | | | | | | | | 7 321 870 |
| | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | |

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE ..................................................... 240 lekë
KODI PENAL ........................................................................ 226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE................................................. 330 lekë
KODI CIVIL ......................................................................... 410 lekë
KODI I PUNËS ...................................................................... 140 lekë
KODI PENAL USHTARAK ........................................................ 55 lekë
KODI I FAMILJES ................................................................. 270 lekë
KUSHTETUTA ........................................................................ 95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE ...................................... 90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE 140 lekë

Hyri në shtyp më 31.12.2009
Doli nga shtypi më 31.12.2009

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë